



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Maj 2021

Nr. 361

VENDIM

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT PËR SHKELJE TË PARASHIKUARA NË KODIN ZGJEDHOR DHE VENDIMIN NR. 9, DATË 24.12.2020 TË KOMISIONIT RREGULLATOR, NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, NDAJ KANDIDATËVE PËR DEPUTETË ZJ. KLEDINA SKËNDO, Z. ALQI BLLAKO DHE BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

VËREN:

Referuar nenit 19, pika 1 shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.



Referuar nenit 7 të vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

- 1- Komisioneri fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitimin e denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejt në KQZ.
- 2- Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë nga paraqitja e tij.
- 3- Afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e “Qëndresës Qytetare” ndaj kandidatëve për deputetë të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Kledina Skëndo dhe z. Alqi Bllako të cilët kanë qenë prezent në dy aktivitete të zhvilluara me mbështetës të forcës politike që përfaqësojnë, në ambientet e bibliotekës së qytetit të Tiranës, “Misto Treska”, dhe Bashkisë Tiranë që ka vendosur në dispozicion këto ambiente, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se:

Edhe pse ka përfunduar afati 60 ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, pasi pritet edhe një përgjigje e Bashkisë Tiranë, rëndësia e së cilës është thelbësore për shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3 e vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:



V E N D O S:

- 1- Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të “Qëndresës Qytetare” për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatëve për deputetë zj. Kledina Skëndo, z. Alqi Bllako dhe Bashkisë Tiranë.

Kopje: 2
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Sulaj _____
M. Koja _____
A.Lamçe _____
Y.Merkaj _____

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

Nr. _____ prot.
Tiranë, më ____ . ____ .2021

